



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 25.09.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 23.09.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “ALBKOS BAU”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe“, Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “ALBKOS BAU”, e dt. 23.09.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe“, Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521, kundër dosjes së tenderit dhe njoftimi për kontratë, të publikuara më datë, të datës 14.09.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET** dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, të publikuara më datë 14.09.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik ALBKOS BAU”, me dt.23.09.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe“, Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 25.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

-Pika ankimore nr.1: Kërkesa për Licencën B2- Refuzohet dhe kriteri mbetet i pandryshuar.

Sipas UA Nr. 02/2025, pika 3.2, Licenca B2 lidhet me zbatimin e punëve të konservimit/restaurimit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme.

Në rastin konkret, bazuar në natyrën dhe përshkrimin e punëve të parapara në kuadër të kësaj kontrate, punët në fjalë kanë karakter të renovimit dhe jo të punëve të konservimit apo restaurimit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme.

Nëse punët konkrete nuk përfshijnë konservim apo restaurim të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, vendosja e Licencës B2 si kusht i detyrueshëm mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për realizimin e punëve të renovimit.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa për Licencën B2 nuk paraqitet si kërkesë e domosdoshme për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate dhe nuk ekziston bazë që kjo licencë të shtohet si kriter i veçantë në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kriteret e kapacitetit profesional dhe teknik duke marrë parasysh natyrën, objektin dhe specifikat e punëve që janë pjesë e kësaj kontrate. Kapaciteti i Operatorëve Ekonomikë për realizimin e këtyre punëve dëshmohet përmes kërkesave të tjera të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përfshirë përvojën profesionale, stafin teknik dhe kapacitetet profesionale e teknike të kërkuara.

-Pika ankimore nr.2: Kërkesa për staf profesional të licencuar-Refuzohet dhe kriteri mbetet i pandryshuar.

Lidhur me pretendimin se Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë, përveç Inxhinierit të Arkitekturës me Licencë A1, edhe staf mbështetës me Licenca A2-1, A2-2 dhe A2-3, sqarojmë se kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit janë hartuar në përputhje me objektin, natyrën dhe kërkesat e kontratës,

-Pika ankimore nr.3: Staf i certifikuar me arsim profesional – Refuzohet dhe kriteri mbetet i pandryshuar.

Autoriteti Kontraktues, në dokumentacionin e tenderit, ka përcaktuar në mënyrë të qartë kërkesat për stafin profesional, përkatësisht profesionet dhe dëshmitë që duhet të paraqiten për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Në përgjigjen ndaj Kërkesës për Sqarime nr. 2, Autoriteti Kontraktues ka sqaruar se pranohen certifikatat e trajnimit profesional për profesionet e kërkuara, sipas emërimit të përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

Sa i përket diplomave të shkollës së mesme profesionale, diploma e shkollës së mesme profesionale dëshmon përfundimin e një niveli dhe drejtimi të caktuar të arsimit, ndërsa certifikata e trajnimit profesional e kërkuar nga AK-ja dëshmon për një trajnim/kualifikim profesional specifik për profesionin e kërkuar.

-Pika ankimore nr.4: Kërkesat për pajisjet- Kërkesat për pajisjet nr. 1, 2, 4, 6, 7 dhe 9 refuzohen dhe mbeten të pandryshuara.

Lidhur me kërkesat për pajisjet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pajisjet e kërkuara janë të nevojshme për realizimin e punëve sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës.

Andaj, duke u bazuar në shqyrtimin e kërkesave të paraqitura, në natyrën dhe specifikat e kontratës, si dhe në nevojën për sigurimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike për realizimin e saj, Autoriteti Kontraktues vendos që kërkesat dhe kriteret e kundërshtuara të mbeten të pandryshuara, ashtu siç janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).